



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CA-2023-02

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Kai Ambos  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 3 prill 2023

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit dhe Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Dosjes së Apelit**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Aleks Uajting

**Mbrojtësit të Salih Mustafës:**  
Julius von Bone

**Mbrojtëses së Viktimave:**  
Ani Puz

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),<sup>1</sup> duke vepruar në pajtim me nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e dorëzuar më 30 mars 2023 nga z. Salih Mustafa (“Mustafa” ose “i akuzuari”).<sup>2</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) u përgjigj më 31 mars 2023.<sup>3</sup>

1. Mustafa kërkon, me urgjencë, zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjes së apelit kundër Aktgjykimit të shqiptuar në çështjen KSC-BC-2020-05 deri “më së voni” 30 prill 2023.<sup>4</sup> Ai parashtron se zgjatja e kërkuar nuk “dëmton” kohëzgjatjen e procesit në mënyrë të paarsyeshme dhe është e përligjur, sepse Aktgjykimi është i gjatë dhe atij i duhet më shumë kohë për të “shtjelluar si duhet” të gjitha pikat e apelit të paraqitura në Njoftimin për Apel.<sup>5</sup> Mustafa argumenton më tej se nuk e ka marrë ende versionin përfundimtar të përkthimit në shqip të Aktgjykimit dhe se është duke punuar në bazë të një përkthimi paraprak.<sup>6</sup> Mustafa parashtron se Zyra Administrative e ka informuar më 27 mars 2023 se do të marrë versionin përfundimtar

---

<sup>1</sup> F00002/COR, Version i Korrigjuar i Vendimit për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 3 janar 2023.

<sup>2</sup> F00018, Mocion Urgjent i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjes së Apelit, 30 mars 2023 (“Kërkesa”).

<sup>3</sup> F00019, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit Urgjent të Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjes së Apelit, 31 mars 2023 (“Përgjigja”). Më 3 prill 2023, duke pasur parasysh afrimin e afatit për dorëzimin e dosjes së apelit të Mustafës, Paneli i Apelit informoi palët dhe pjesëmarrësit me mesazh elektronik për rezultatin e këtij Vendimi; shih CRSPD5 (Korrespondenca 5), mesazh elektronik lidhur me F00018 dhe F00019, 3 prill 2023.

<sup>4</sup> Kërkesa, para. 4-8, 10-11, 13-15. Shih KSC-BC-2020-05, F00494/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit, 24 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 dhjetor 2022; versioni i pakorrigjuar i redaktuar publik u dorëzua më 19 janar 2023) (“Aktgjykimi”). Gjithashtu, Mustafa parashtron se në rast se Kërkesa miratohet, zgjatje të afatit dhe shtime të barasvlershme të numrit të lejuar të fjalëve duhen miratuar edhe për çdo dosje të përgjigjes. Shih Kërkesën, para. 12, 17.

<sup>5</sup> Kërkesa, para. 4, 6, që i referohet F00006/RED2, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit të Apelit të Mbrojtjes sipas Rregullës 176 (të Rregullores së Procedurës dhe të Provave) kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykses I të 16 dhjetorit 2022, 13 shkurt 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 2 shkurt 2023) (“Njoftimi për Apel”).

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 7.

të përkthyer të Aktgjykimit më 17 prill 2023, dhe rrjedhimisht kërkon “kohë të mjaftueshme” për të bërë ndonjë ndryshim të mundshëm në dosjen e tij të apelit pas asaj date.<sup>7</sup>

2. Gjithashtu, Mustafa kërkon shtimin e numrit të lejuar të fjalëve, të përcaktuar në nenin 48 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”),<sup>8</sup> për dorëzimin e dosjes së apelit kundër Aktgjykimit.<sup>9</sup> Ai kërkon shtimin e 10.000 fjalëve, duke argumentuar se “numri aktual i fjalëve për këtë dokument nuk do të mjaftonte”.<sup>10</sup>

3. ZPS-ja përgjigjet se nuk ka ndonjë qëndrim lidhur me “mocionin e minutës së fundit” të Mustafës për zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjes së tij të apelit, por kundërshton shtimin e numrit të lejuar të fjalëve.<sup>11</sup> Ajo argumenton se kërkesa e pambështetur e Mustafës për shtimin e 10.000 fjalëve nuk ofron asnjë rrethanë të posaçme për ta përligjur atë, siç kërkohet nga neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës, dhe se, për më tepër, kërkesa është dorëzuar vetëm dy ditë pune përpara afatit të dorëzimit të dosjes së tij të apelit.<sup>12</sup>

4. Paneli i Apelit kujton se më 9 janar 2023, me kërkesë të Mustafës, Paneli zgjati afatin e Mustafës dhe ZPS-së për dorëzimin e njoftimeve për apel, nëse do të kishte të

---

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 7.

<sup>8</sup> KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative: Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës”).

<sup>9</sup> Kërkesa, para. 9, 16.

<sup>10</sup> Kërkesa, para. 9.

<sup>11</sup> Përgjigjja, para. 1-2, 6. Ndonëse nuk kundërshton zgjatjen e kërkuar të afatit, ZPS-ja megjithatë parashtron se Paneli i Apelit ka konstatuar tashmë se gjatësia dhe kompleksiteti i Aktgjykimit nuk përligjin zgjatjen e afatit për dorëzimin e Njoftimit për Apel, se bashkëmbrojtësi që flet shqip ka pasur mundësi të shumta për ta këshilluar Mustafën lidhur me Aktgjykimin dhe se, në rast se nga përkthimi përfundimtar dalin probleme të konsiderueshme, Mustafa mund të kërkojë leje të dorëzojë parashtrime të mëtejshme; shih Përgjigjen, para. 3-5.

<sup>12</sup> Përgjigjja, para. 2, 6. ZPS-ja parashtron më tej se nëse Paneli i Apelit miraton masën ndreqëse të kërkuar nga Mustafa, ZPS-ja kërkon zgjatje të afatit dhe shtimin përkatës të numrit të lejuar të fjalëve për dosjen e vet të përgjigjes; shih Përgjigjen, para. 7.

tilla, deri më 3 shkurt 2023.<sup>13</sup> Më 2 shkurt 2023, Mustafa dorëzoi Njoftimin për Apel kundër Aktgjykimit.<sup>14</sup>

5. Paneli kujton më tej se më 16 shkurt 2023, Kryegjykatësja e Panelit të Apelit mbajti Konferencën e Para Apelit, në të cilën Zyra Administrative parashtroi se përkthimi i paredaktuar në shqip i Aktgjykimit ishte shpërndarë atë ditë dhe se Zyra Administrative po punonte për përgatitjen e versionit përfundimtar të tij deri në fund të marsit 2023.<sup>15</sup>

6. Për sa i përket dorëzimit në kohë të kërkesës së Mustafës për zgjatjen e afatit dhe shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për dorëzimin e dosjes së apelit, Paneli i Apelit kujton së pari se, sipas rregullës 179(1) të Rregullores, apeluesi duhet ta dorëzojë dosjen e apelit brenda 60 ditësh nga njoftimi për apel. Megjithatë, Paneli mund, *proprio motu* ose pasi t'i tregohen arsye të vlefshme, të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara në Rregullore apo prej Panelit.<sup>16</sup> Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton se pjesëmarrësit në proces mund të kërkojnë paraprakisht në kohë të mjaftueshme, shtimin e numrit të lejuar të fjalëve pasi të tregojnë se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të posaçme.

7. Paneli vëren se në përputhje me rregullat 9(2) dhe 179(1) të Rregullores, dosja e apelit të Mustafës duhet të dorëzohet deri më 3 prill 2023. Paneli rikujton se në Vendimin mbi Ndryshimin e Afatit për Njoftimin e Apelit, ai vuri në dukje se me zgjatjen e afatit që Paneli i miratoi Mustafës për dorëzimin e njoftimit për apel më

---

<sup>13</sup> F00004, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 9 janar 2023 ("Vendimi mbi Ndryshimin e Afatit për Njoftimin e Apelit"), para. 7-8, 11. Shih gjithashtu, F00001, Mocion Urgjent i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 3 janar 2023.

<sup>14</sup> Njoftimi për Apel.

<sup>15</sup> Transkripti, 16 shkurt 2023, f. 6, ku Zyra Administrative vuri në dukje më tej se "bashkë me versionin përfundimtar, do të shpërndajmë një version ku do të pasqyrohen ndryshimet e mundshme midis përkthimit të paredaktuar të shpërndarë sot dhe versionit përfundimtar të tij, për t'ua bërë më të lehtë lexuesve". Shih gjithashtu, F00008, Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës Para Apelit, 9 shkurt 2023, para. 11.

<sup>16</sup> Rregulla 9(5)(a) e Rregullores.

3 shkurt 2023, “dosjet e apelit normalisht do të duhej të dorëzoheshin deri më 6 prill 2023”.<sup>17</sup> Megjithatë, meqë Njoftimi për Apel i Mustafës u dorëzua dhe shpërnda më 2 shkurt 2023, d.m.th. një ditë më herët, dosja e tij e apelit duhet dorëzuar deri më 3 prill 2023.

8. Paneli vëren se më 27 mars 2023, Zyra Administrative e informoi Mustafën se versioni përfundimtar i përkthimit në shqip të Aktgjykimit nuk pritej të ishte gati deri më 17 prill 2023.<sup>18</sup> Megjithatë, edhe pse Kërkesa mbështetet vetëm pjesërisht në këtë arsye, Mustafa duhej të kishte dorëzuar Kërkesën menjëherë, për shembull, më 28 mars 2023. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se në këtë aspekt, Kërkesa qartësisht nuk është bërë brenda afatit.

9. Sidoqoftë, Paneli do të shqyrtojë nëse Mustafa demonstroi arsye të vlefshme për kërkesat e tij për ndryshimin e afatit dhe të numrit të lejuar të fjalëve për dorëzimin e dosjes së apelit.

10. Paneli kujton së pari se, kur shqyrtoi kërkesën e Mustafës për zgjatjen e afatit për dorëzimin e Njoftimit për Apel, nuk u bind se Aktgjykimi është i gjatë apo ndryshe i ndërlikuar në mënyrë që do të përlligjte zgjatjen e afatit.<sup>19</sup> Paneli gjithashtu gjykon se nevoja për kohë shtesë “për të shtjelluar si duhet” të gjitha pikat e apelit që Mustafa vendosi të paraqiste në Njoftimin për Apel, nuk përbën arsye të vlefshme për miratimin e zgjatjes së afatit. Megjithatë, Paneli vlerëson se vonesa e Zyrës Administrative në dorëzimin e versionit përfundimtar të përkthimit të Aktgjykimit deri më 17 prill 2023, përbën arsye të vlefshme për ndryshim të kufizuar të afatit për dorëzimin e dosjes së apelit.

11. Për mendimin e Panelit, zgjatja e afatit për dorëzimin e dosjes së apelit të Mustafës deri më 24 prill 2023, do t'i jepte atij kohë të mjaftueshme pas shpërndarjes

---

<sup>17</sup> Vendimi mbi Ndryshimin e Afatit për Njoftimin e Apelit, para. 9.

<sup>18</sup> *Shih* Kërkesën, para. 7.

<sup>19</sup> *Shih* Vendimin mbi Ndryshimin e Afatit për Njoftimin e Apelit, para. 4.

së versionit përfundimtar të përkthimit të Aktgjykimit, duke mbajtur parasysh se një përkthim i paredaktuar i është vënë në dispozicion që në mes të shkurtit 2023. Paneli thekson gjithashtu se Zyra Administrative parashtroi se, bashkë me versionin përfundimtar të përkthimit, do të shpërndante edhe një version ku do të pasqyrohej çdo ndryshim i mundshëm midis përkthimit të paredaktuar dhe versionit përfundimtar të përkthimit të Aktgjykimit.<sup>20</sup> Paneli gjykon se kjo gjë do ta ndihmojë Mustafën në finalizimin e dosjes së apelit në mënyrë më efikase brenda afatit të dhënë.

12. Për sa u përket arsyeve të vlefshme për shtimin e kërkuar të numrit të lejuar të fjalëve për dosjen e apelit, Paneli rikujton se, sipas nenit 48(3) të Udhëzuesit të Punës, Mustafa mund të dorëzojë një dosje apeli me jo më shumë se 30.000 fjalë. Paneli rithekson se cilësia dhe efektshmëria e parashtrimeve në apel nuk varen nga gjatësia, por nga qartësia dhe logjika e tyre, dhe se numri i pikave dhe nënpikave të apelit jodomosdoshmërisht pengojnë apeluesin të paraqesë dosje apeli me argumente thelbësore dhe bindëse brenda numrit të lejuar të fjalëve, dhe se, si të tilla, ato në vetvete nuk përbëjnë rrethana të posaçme.<sup>21</sup>

13. Në Kërkesën e vet, Mustafa nuk jep arsye bindëse për kërkesën e tij për 10.000 fjalë shtesë për dosjen e apelit dhe Paneli gjykon se një shtim i tillë fjalësh nuk është i përligjur mbështetur në kompleksitetin e Aktgjykimit apo numrin e pikave të apelit të paraqitura në Njoftimin për Apel. Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë këtë aspekt të Kërkesës.

14. Në lidhje me zgjatjen e kërkuar të afateve përkatëse për dorëzimin e dosjeve të përgjigjeve, Paneli nuk është bindur në këtë fazë për domosdoshmërinë e miratimit të zgjatjes së tyre. Rrjedhimisht, Paneli vë në dukje se, sipas rregullës 9(2) të

---

<sup>20</sup> *Shih* Transkriptin, 16 shkurt 2023, f. 6.

<sup>21</sup> *Shih*, p.sh., KSC-CA-2022-01, F00033, Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Dosjes së Apelit, 5 gusht 2022, para. 7; KSC-CA-2022-01, F00021, Vendim mbi Kërkesën e Haradinajt për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Dosjes së Apelit dhe mbi Kërkesën e ZPS-së për Urdhër për Ridorëzimin e Njoftimit për Apel të Haradinajt, 1 korrik 2022, para. 4-5.

Rregullores, afatet përkatëse të përcaktuara në rregullën 179(2) dhe (3) të Rregullores për dorëzimin e dosjes së përgjigjes dhe dosjes kundërpërgjigjëse fillojnë përkatësisht nga dita e parë e punës pas njoftimit të dosjes së apelit të Mustafës dhe pas njoftimit të dosjes përkatëse të përgjigjes.

15. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**MIRATON** Kërkesën, pjesërisht;

**AUTORIZON** Mustafën të dorëzojë dosjen e apelit deri më 24 prill 2023; dhe

**HEDH POSHTË** pjesën tjetër të Kërkesës.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Mishelë Pikar**  
**Kryegjykatëse**

E hënë, 3 prill 2023

Në Hagë, Holandë.